



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.07.2023, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**Mbyllet rasti APK-DPKI-06-707/23, lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike në Pejë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

## A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) - Qendra Rajonale Shëndetësisë Publike në Pejë (QRSHP), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit të ndërlidhur me konkursin e shpallur në mars të vitit 2018 nga IKSHPK për pozitën 'Arkëtar' në QRSHP Pejë (i anuluar më pas), i njëjti i rishpallur në vitin 2019 (prapë i anuluar), dhe së fundi i shpallur në vitin 2022, i cili rezultoi me punësimin e A. L. në pozitën Arkëtar - QRSHP Pejë, e që i njëjti (sipas raportueses së rastit) do t'i raportoj vëllait të tij A. L., Drejtor Financiar në IKSHPK Prishtinë.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion plotësues nga menaxhmenti i QRSHP Pejë, të cilin e ka pranuar më pas (shkresat zyrtare: DPKI-06-785/23, DPKI-06-785-1/23).

Nga kërkesa e raportuesit të rastit, takimin e mbajtur dhe dokumentacioni i siguruar nga menaxhmenti i QRSHP Pejë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konstaton gjendjen faktike si në vijim:

- Në mars të vitit 2018, IKSHPK kishte shpallë konkurs për pozitën 'Arkëtar' për QRSHP Pejë, të cilin e kishte anuluar më pas, pastaj të njëjtin i kishte rishpallur në vitin 2019, dhe gjithashtu e kishte anuluar më pas;

- Konkursi i (ri)shpallur më 19.09.2022, për pozitën Arkëtar- QRSHP Pejë (i referuar më sipër), pas përfundimit të të gjitha procedurave të tij, IKSHHP përmes Drejtorit Ekzekutiv<sup>1</sup> si përfaqësues i saj, ka lidhë kontratë pune me A.L. - Arkëtar - QRSHP Pejë (*kontrata me nr. Prot 1315, dt. 20.12.2022, i është bashkangjitur përgjigjes/deklaratës me shkrim të Drejtores së QRSHP Pejë*);

- Në përgjigjen/deklaratën me shkrim të Drejtoreshës së QRSHP Pejë znj. A. N., theksohet gjithashtu se, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i të gjithë personelit në QRSHP Pejë është Drejtoresha e QRSHP Pejë, (pra ajo vet, v.j.), e njësoj edhe i arkëtarit në fjalë;

- Drejtoresha e QRSHP Pejë, bën vlerësimin vjetor të të gjithë personelit (si provë ka bashkangjitur formularët e vlerësimit), gjithashtu, përgjigjes i ka bashkangjitur edhe disa raporte financiare si dhe fatura tjera ku dokumentohet se ato nënshkruhen nga A.L. dhe Drejtoresha A.N si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e tij.

Pas vlerësimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Fillimisht, sa i përket pretendimeve për konflikt të interesit që ndërliken me konkursin e shpallur në mars të vitit 2018 nga IKSHPK për pozitën 'Arkëtar' në QRSHP Pejë (i anuluar më pas), i njëjti i rishpallur në vitin 2019 (prapë i anuluar), zbatohet dispozita e nenit 22 [Procedura Administrative e Agjencisë për rastet e Konfliktit të Interesit], paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e cila përcakton se:

*"Inicimi i procedurës për konflikt të interesit në Agjenci nuk mund të fillojë në qoftë se kanë kaluar dy (2) vite nga data e kryerjes së veprimit, përveç kur parashihet ndryshe me ligj".*

Rrjedhimisht, nga koha e shpalljes së këtyre dy konkurseve (2018, përkatësisht 2019, koha e kryerjes së veprimit), dhe raportimi në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, kanë kaluar më shumë se dy (2) vite, prandaj *nuk mund të iniciohet procedurë për konflikt të interesit në Agjenci.*

Ndërsa, sa i përket konkursit të shpallur nga IKSHPK më 19.09.2022, për pozitën 'Arkëtar', QRSHP, dega në Pejë, i cili rezultoi me punësimin e A.L. në pozitën Arkëtar - QRSHP Pejë, mbështetur në dokumentacionin në dispozicion (takimin, deklaratën dhe dokumentacioni tjetër të bashkangjitur në përgjigjen e Drejtoreshës së QRSHP Pejë), nuk është gjetur se A.L. në pozitën Arkëtar - QRSHP Pejë, i raporton vëllait të tij A.L., Drejtor Financiar në IKSHHP Prishtinë, e as ndonjë raport tjetër pune a ndërvarësie hierarkike apo vendimmarrjeje mes tyre, por rezulton se A.L., Arkëtar - QRSHP Pejë, i raporton drejtpërsëdrejti Drejtoreshës së QRSHP Pejë.

Gjithsesi, në rastin konkret, për shkak të afërsisë familjare të nëpunësve në fjalë, udhëheqësi i zyrtarit ose institucioni udhëheqës gjithnjë duhet të ketë parasysh dhe merr masat e nevojshme,

<sup>1</sup> Drejtori Ekzekutiv i IKSHHP-së nënshkruan të gjitha kontratat e punëtorëve të pranuar në IKSHHP dhe QRSHP-të Rajonale (sqarim i dhënë në deklaratën me shkrim të Drejtoreshës së QRSHP Pejë).



për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesit për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësive të caktuara të zyrtarit, konform nenit 19, paragrafi 2, nënparagrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, dhe paragrafit 3, të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit [Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave], i cili përcakton se:

“[...]

2. Çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësive të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen:

2.1. kufizimin e informatave të caktuara për zyrtarin ose shmangien e detyrave dhe përgjegjësive që përbëjnë shkak në shfaqjen e konfliktit të interesit ose të papajtueshmërive;

2.2. përjashtimin e zyrtarit nga pjesëmarrja në vendimmarrje;

2.3. rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit ose transferimin në një detyrë tjetër që mënjanon konfliktin e interesave, për aq sa nuk parashihet ndryshe me ligj;

2.4. shmangien e emërimit ose të zgjedhjes së zyrtarit në funksione në të cilat ekzistojnë ose mund të lindin konflikte të interesave;

[...]

3. Pavarësisht masave bazë të mësipërme dhe çdo mase tjetër të paraparë me ligj, zyrtari ose udhëheqësi i tij sipas hierarkisë nuk përjashtohen nga përgjegjësia kur masat e marra nuk japin efekt në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas këtij ligji.

[...].”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Udhëheqësit të Institucionit publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Bufleshtaj  
Drejtori i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

